



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.173/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Rustem Thaqi dhe Zyhdi Haziri anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Fatjona Bekteshi, duke vendosur përkitazi me ankesën e BIRN dhe IKS me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për shkak të bërjes së fushatës zgjedhore me fëmijë të mitur, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 06 tetor 2019, në seancën e panelit të mbajtur më datë 04.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet e bazuar ankesa Anr.173/2019 e datës 01.10.2019 e paraqitur nga BIRN dhe IKS me seli në Prishtinë, subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, i shqiptohet dënimi më gjorbë në lartësi prej 2,500.00 (dy mijë e pesëqind) euro, për shkak të bërjes së fushatës zgjedhore me fëmijë të mitur, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarrimit.

A r s y e t i m

Me datën 01.10.2019, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga BIRN dhe IKS me seli në Prishtinë, me të cilën pretendon se me datën 30.09.2019, rreth orës 19:00, në tubimin zgjedhor të Partisë Demokratike të Kosovës në Drenas janë parë fëmijë duke mbajtur materiale promovuese të fushatës. Këto fotografi janë shfaqur në transmetimin e drejtpërdrejtë të fushatës së PDK-së, në Drenas, aty shihen dy fëmijë nën moshën 15 vjeçare të veshur me bluza me mbishkrimin Partia Demokratike e Kosovës, dhe duke mbajtur flamur të këtij subjekti në duar gjatë tubimit, kështu duke vepruar në kundërshtim me Rregulloren 20/2019 për Fushatën e Zgjedhjeve dhe Njoftimi për Ngjarjet, përkatësisht nenin 5 par. 3 pikën b). Si prova për pretendime e tyre i kanë bashkangjitur ankesës një video ku shihen fëmijët me materiale promovuese politike.

Subjekti politik PDK, në përgjigje në ankesë të datës 02.10.2019, konsideron se shkelja nuk është në kundërshtim me Rregulloren 20/2019 respektivisht nenin 2 të kësaj Rregullore, pasi që në tubime të tilla prezenca e fëmijëve është vështirë e ndalshme dhe në të shumtën e rasteve janë në përcjellje të prindërve, pa asnjë aktivitet në këto tubime.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga video e paraqitur si provë nga parashtruesi i ankesës shihet qartë se fëmijët janë të pajisur me materiale promovuese politike të subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), veprime këto të ndaluara sipas Rregullës Zgjedhore Nr.20/2019 të datës 26.09.2019, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullës Zgjedhore Nr.13/2013, për “Fushatën e Zgjedhjeve dhe Njoftimin për Ngjarjet Politike”, respektivisht nenin 2 par.3, pika b), c) dhe d) të kësaj Rregulle, e cila dispozitë përcakton se: “ ... asnjë subjekt politik i

certifikuar nuk mund të përfshinë personat të cilët nuk i kanë mbushur 15 vjet në veprimet e mëposhtme: ...; b) bartin pankarta dhe materiale tjera promovuese gjatë aktivitetit të fushatës zgjedhore; c) të jenë pjesë aktive e materialeve promovuese politike për të shmangur etiketimin e mundshëm, ngacmimin dhe çfarëdo ndikimi tjetër negativ të tyre; d) të jenë pjesë aktive e materialeve promovuese politike në fushatë zgjedhore me qëllim për të marrë vota emocionale të elektoratit”.

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e subjektit politik PDK, është shkelur neni 2 par.3 pika b), c) dhe d) i Rregullës Zgjedhore Nr.20/2019 të datës 26.09.2019, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullës Zgjedhore Nr.13/2013, për “Fushatën e Zgjedhjeve dhe Njoftimin për Ngjarjet Politike”, pasi që fëmijët në tubimin e fushatës zgjedhore, kanë qenë duke mbajtur në duar dhe në veshjet e tyre material promovues politik për subjektin politik PDK.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret, se subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se është njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe përkundër këtij fakti nga ana e këtij subjekti gjatë aktivitetit të fushatës zgjedhore janë përdorur personat e mitur dhe atë edhe duke mbajtur material promovues të subjektit politik PDK, gjë e cila është në kundërshtim me dispozitat e lartëcekura ligjore.

Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që subjektit politik në fjalë, iu dha mundësia për tu përgjigjur në ankesë, mirëpo subjekti politik nëpërmes përgjigjes në ankesë shihet qartë se nuk e ka pranuar shkeljen dhe për më tepër ka deklaruar se ky veprim i tyre nuk është në kundërshtim me dispozitat ligjore, veprime këto të cilat kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi. Kjo për faktin se subjekti në fjalë nuk ka ndërmarr masa për përmirësimin e sanksionin në kuptimin të nenit 120.1 të LPZ

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.173/2019 më datën 04.10.2019

Kryesuesi i Panelit
Fejzullah Rexhepi



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.